

# RELACION

## PËR

### PROJEKTLIGJIN “PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË LIGJIN NR.79/2017, “PËR SPORTIN””

#### **I. QËLLIMI I PROJEKTAKTIT DHE OBJEKTIVAT QË SYNOHEN TË ARRIHEN**

Projektligji “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.79/2017, “Për sportin”” ka si qëllim përmirësimin e infrastrukturës sportive, duke qenë se sporti jep një kontribut të rëndësishëm në kohezionin ekonomik dhe shoqëror.

Sporti adreson nevojat dhe gjendjen specifike të grupeve sensitive, duke marrë parasysh rolin e veçantë që mund të luajë për të rinjtë, njerëzit me aftësi të kufizuara dhe njerëzit me prejardhje më pak të privilegjuara.

Sporti, gjithashtu, mund të lehtësojë integrimin në shoqëri, si dhe të mbështesë dialogun ndërkulturor.

Sporti, sipas legjislacionit shqiptar, konsiderohet si një e drejtë e aksesueshme për të gjithë.

#### **II. VLERËSIMI I PROJEKTAKTIT NË RAPORT ME PROGRAMIN POLITIK TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, ME PROGRAMIN ANALITIK TË AKTEVE DHE DOKUMENTE TË TJERA POLITIKE**

Ky projektligj është në përputhje të plotë me programin politik të Këshillit të Ministrave.

#### **III. ARGUMENTIMI I PROJEKTLIGJIT LIDHUR ME PËRPARËSITË, PROBLEMATIKAT, EFEKTET E PRITSHME**

Me anë të këtij projektligji synohet të përmirësohet marrëdhënia ndërmjet tifozëve, organizatave dhe klubeve sportive, marrëdhënie e cila duhet të trajtohet e të perceptohet nga palët si një marrëdhënie ortakërie me karakter parandalues për trazirat në sport.

Kreu “Parandalimi i dhunës në sport” në ligjin për sportin, duke reflektuar detyrimet që sjell ratifikimi i Konventës Evropiane Kundër Dhunës në Sport, si dhe rekomandimet e organizatave ndërkombëtare në lidhje me parandalimin dhe menaxhimin e situatave të shfaqjes së dhunës para, gjatë dhe pas veprimtarive sportive dhe kryesisht në ndeshjet e futbollit, është parë si një përparësi për të parandaluar këto fenomene.

Projektligji parashikon pajisjen e tifozëve me kartën e tifozit, e cila duhet të jetë një marrëveshje e detyrueshme ndërmjet tifozëve dhe organizatës sportive/klubit.

Karta e tifozit duhet të përpunohet dhe të adaptohet bashkërisht nga organizatat/klubet sportive dhe nga përfaqësues të tifozërisë së tyre, të përcaktojnë qëllime të përbashkëta, si dhe detyrimet e organizatës/klubit ndaj tifozëve të saj dhe anasjelltas, detyrimet e tifozëve drejt organizatës/klubit.

Duke qenë që asnjë sportist nuk mund të anëtarësohet në një federatë dhe të marrë pjesë në veprimtaritë sportive të organizuara prej saj pa paraqitur vërtetimin mjekësor që e lejon atë të ushtrojë sportin që ka zgjedhur, projektligji synon përjashtimin nga detyrimet doganore dhe tatimi mbi vlerën e shtuar të ndihmave apo të sponsorizimeve me materiale dhe pajisje sportive për organizatat sportive shqiptare, të cilat vijnë nga institucione ndërkombëtare apo çdo formë tjetër sponsorizimi, në kuadër të bashkëpunimit, nxitjes së sportit dhe rritjes së nivelit të sportit në rang ndërkombëtar.

Efekti i pritshëm i këtij projektligji është përmirësimi i situatës në fushën e sportit nëpërmjet lehtësirave të parashikuara në këtë projektligj.

#### **IV. VLERËSIMI I LIGJSHMËRISË, KUSHTETUTSHMËRISË DHE HARMONIZIMI ME LEGJISLACIONIN NË FUQI VENDAS E NDËRKOMBËTAR**

Ky projektligj është hartuar në mbështetje të neneve 78, pika 1, dhe 83, të Kushtetutës.

#### **V. VLERËSIMI I SHKALLËS SË PËRAFRIMIT ME *ACQUIS COMMUNAUTAIRE* (PËR PROJEKTAKTET NORMATIVE)**

Ky projektligj nuk synon përafrimin me ndonjë *acquis* të BE-së.

#### **VI. PËRMBLEDHJE SHPJEGUESE E PËRMBAJTJES SË PROJEKAKTIT**

Projektligji përbëhet nga 5 nene.

Në këtë projektligj është parashikuar që në nenin 3, të ligjit të sportit, të përfshihet për herë të parë koncepti i “Kartës së tifozit”, e cila është një marrëveshje ndërmjet tifozëve dhe organizatës sportive.

Në kartën e tifozit do të përcaktohen të drejtat dhe detyrimet e organizatës sportive ndaj tifozëve të saj, si dhe anasjelltas, sanksionet lidhur me rastet e shkeljes së kësaj marrëveshjeje, si dhe rregulla lidhur mbi mbarëvajtjen e veprimtarisë sportive, brenda e jashtë vendit.

Karta e tifozit lëshohet nga organizata sportive, pas anëtarësimit të tifozit, sipas llojit të veprimtarisë sportive që kjo organizatë ushtron.

Kjo kartë duhet të përmbajë rregulla lidhur me çështjet e anëtarësisë, konsultimin dhe informimin, aksesin dhe përdorimin e stadiumeve, sigurinë dhe mbrojtjen e spektatorit, tregtimin lidhur me shitjen e biletave, aktivitetet e adresuara komunitetit si dhe rregulla të tjera kundër racizmit, dhunës, ksenofobisë, diskriminimit në futboll.

Projektligji parashikon që rregulla lidhur me procedurën dhe mënyrën për pajisjen me kartën e tifozit të përcaktohen në rregulloren e brendshme të organizatës sportive.

Gjithashtu, nëpërmjet këtij projektligji parashikohet ndryshimi i pikave 5 e 6, të nenit 7, të ligjit nr.79/2017, “Për sportin”, në të cilat sanksionohet përjashtimi nga detyrimet doganore dhe tatimi mbi vlerën e shtuar për ndihmat apo sponsorizimet me materiale sportive, pajisje sportive, barna dhe pajisje mjekësore në funksion të sportit, për organizatat sportive dhe për Qendrën e Shërbimit të Sportit, të cilat vijnë nga institucione sportive ndërkombëtare apo çdo formë tjetër sponsorizimi, në kuadër të bashkëpunimit, nxitjes së sportit dhe rritjes së nivelit të sportit në rang ndërkombëtar.

Procedurat për përjashtimin dhe listat e materialeve e të pajisjeve sportive e ato mjekësore në funksion të sportit miratohen nga Këshilli i Ministrave.

Projektligji parashikon shtimin e nenit 13/1, i cili përcakton mbështetjen e klubeve sportive të futbollit të superligës, me financime nga ana e organeve të vetëqeverisjes vendore, vetëm në rast se të gjithë futbollistët e klubit e kanë pagën mujore jo më të vogël se 100 000 (njëqind mijë) lekë (bruto).

## **VII. INSTITUCIONET DHE ORGANET E TJERA QË NGARKOHEN PËR ZBATIMIN E PROJEKTAKTIT**

Ngarkohen Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe organizatat sportive për zbatimin e këtij projektligji.

## **VIII. MINISTRITË, INSTITUCIONET DHE SUBJEKTET E TJERA QË KANË KONTRIBUAR NË HARTIMIN E PROJEKTLIGJIT**

Projektligji është hartuar nga grupi ndërinstitucional i punës, i ngritur me urdhrin nr.57, datë 25.3.2019, të Kryeministrit, “Për ngritjen dhe funksionimin e Komisionit Ndërinstitucional për Reformën në Sport”.

Projektligji është bashkërenduar me të gjitha ministrinë e linjës.

## **IX. RAPORTI I VLERËSIMIT TË TË ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE BUXHETORE**

Referuar çmimit të materialeve sportive të cilat parashikohet të importohen, sasisë së parashikuar për t’u importuar gjatë një viti, ku mesatarisht është përlllogaritur një sasi importi prej 30 pajisjesh në vit, vlerësohet se impakti në buxhet nga ky propozim është rreth 180 milionë lekë në vit (tarifa doganore+TVSH) të ardhura të munguara në buxhetin e shtetit.

Në tabelën më poshtë jepen lista e materialeve që parashikohet të importohen si dhe përlllogaritjet për impaktin në buxhet.

<b>LISTA E MATERIALEVE DHE PAJISJEVE SPORTIVE - 22.01.2020 (SHTESAT)</b>					
<b>Nr.</b>	<b>FEDERATA SHQIPTARE DHE KLUBET SPORTIVE SHQIPTARE TË</b>	<b>Vlera e materialeve / pajisjeve (lekë)</b>	<b>TVSH (%)</b>	<b>tarifat doganore</b>	<b>efekti vjetor</b>
	<b>QENDRA E SHËRBIMIT TË SPORTIT (MJEKËSIA SPORTIVE)</b>				
1	Laboratori i analizave: Cell counter, analizator biokimik automatik, urinometër, densimetër, centrifugë, mikroskop, aerosteril, banjomari. Reagentë për analizat e gjakut, strisho për urinën.		0		
2	Laboratori i ekzaminimeve funksionale: Biçikletë ergometrike multifunksionale ekg. Pistë vrapimi profesionale me ekg, matës të potencës metabolike, kardiofrekuencometër Polar gps, Dinamometra, spirometër elektronik, analizator i përbërjes tripode, EKG 3-10 kanale, pulsometër.				
3	Fizioterapija: Tecar, ultratinguj, laser, magnetoterapi, shok terapi, infrared, vakum terapi, elektrostimulatorë, defibrilator.				
4	Analizator për Fuqinë Metabolike GPEXE				
5	Çanta mjekësore profesionale				
6	Autobus (copë 1)				
	<b>SHUMA TOTALE</b>	<b>19,942,000</b>	<b>3,988,400</b>		
	Cell counter	780,000	156,000	78,000	7,020,000
	Analizator biokimik automatik	260,000	52,000	26,000	2,340,000
	Urinometër	130,000	26,000	13,000	1,170,000
	Densimetër	104,000	20,800	10,400	936,000
	Centrifuge	65,000	13,000	6,500	585,000
	Mikroskop	195,000	39,000	19,500	1,755,000
	Aerosteril	260,000	52,000	26,000	2,340,000
	Banjomari	130,000	26,000	13,000	1,170,000
	Reagent për analiza	325,000	65,000	32,500	2,925,000
	Strisho për urinën	65,000	13,000	6,500	585,000
	Biçikletë ergometrike multifunksionale EKG	650,000	130,000	65,000	5,850,000
	Piste vrapimi profesionale me EKG	1,105,000	221,000	110,500	9,945,000
	Matës te potencës metabolike	520,000	104,000	52,000	4,680,000

	Kardiofrekuenciometer Polar GPS	390,000	78,000	39,000	3,510,000
	Dinomometër	130,000	26,000	13,000	1,170,000
	Spirometër elektronik	260,000	52,000	26,000	2,340,000
	Analizator i përbërjes tripode	650,000	130,000	65,000	5,850,000
	EKG 3-10 kanale	325,000	65,000	32,500	2,925,000
	Pulsometer	78,000	15,600	7,800	702,000
	Tecar	780,000	156,000	78,000	7,020,000
	Ulratinguj	260,000	52,000	26,000	2,340,000
	Lazer	195,000	39,000	19,500	1,755,000
	Magneto Terapi	130,000	26,000	13,000	1,170,000
	Shok terapi	1,430,000	286,000	143,000	12,870,000
	Infrared	65,000	13,000	6,500	585,000
	Vakum terapi	104,000	20,800	10,400	936,000
	Elektrostimulator	130,000	26,000	13,000	1,170,000
	Defibrilator	130,000	26,000	13,000	1,170,000
	Analizator për fuqinë metabolike GPEXE	520,000	104,000	52,000	4,680,000
	Çanta mjekësore profesionale	26,000	5,200	2,600	234,000
	Autobus 30-32 vendësh	9,750,000	1,950,000	975,000	87,750,000
	<b>SHUMA</b>	<b>19,942,000</b>	<b>3,988,400</b>	<b>1,994,200</b>	<b>179,478,000</b>

## KËSHILLI I MINISTRAVE